



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 71, Datë 10.03.2026

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “SUNNY SIDE ENERGY” SH.P.K. PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET BARRËSIMIT) TË ASETVEVE FIKSE TË SAJ SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA” SH.A.**

Në mbështetje të neneve 16, 20, gërma “a”, dhe 44 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; neneve 2, gërma “a”, 3, 4, gërmat “a” dhe “b”, 5, gërma “j”, 6, 7 dhe 8 të Rregullores së procedurave të transferimit të asetëve nga të licensuarit, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.07.2016; nenit 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe pikave 1.3 dhe 1.6 të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.03.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 844 prot., datë 06.03.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Sunny Side Energy” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet marrëveshjes sigurose) të asetëve fikse të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Intesa SanPaolo Bank Albania” sh.a.”,

**Konstatohet se:**

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për shoqërinë “Sunny Side Energy” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

**1. Kërkesa për Marrjen e Autorizimit**

- Shoqëria “Sunny Side Energy” sh.p.k., është licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 13, datë 16.01.2025, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria me shkresën nr. 620 prot., datë 11.02.2026, ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e asetëve fikse të saj, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “Intesa SanPaolo Bank Albania” sh.a.
- ERE ka evidentuar një mosrakordim midis vlerës totale të asetëve të centralit të parashikuar në marrëveshjen sigurose të përcjellë, e cila rezulton më e vogël krahasuar me totalin e vlerës së kredisë së marrë, e nga ana tjetër dhe vlerës së parashikuar të investimit, nga kontrata e nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), datë 11.11.2024.

- ERE me e-mailin e datë 24.02.2026, të protokolluar në vijim në ERE me nr. 620/1 prot., datë 24.02.2026 i kërkoi shoqërisë/bankës financuese të bëjnë sqarimet/saktësimet përkatëse në lidhje me monedhën/vlerën totale të aseteve fikse për të cilat kërkohet miratimi përkatës.
- Në përgjigje, “Intesa SanPaolo Bank Albania” sh.a. nëpërmjet e-mailit datë 24.02.2026, dhe shkresës nr. 620/2 prot., datë 25.02.2026, ka bërë me dije se ka pasqyruar gabim monedhën (e cila nuk është Lekë por Euro), ndaj ka bërë korigjimin/saktësimin e monedhës nga Lekë në Euro, nëpërmjet Marrëveshjen Siguruese nr. 1083 rep., nr. 458 kol., datë 24.02.2026 (*amendim bazuar në Marrëveshjen Siguruese të mëparshme me nr. 519 rep, nr. 194 kol, datë 29.01.2026*), të cilën e ka përcjellë në ERE.
- Në mbledhjen e bordit të ERE-s në datë 26.02.2026 u relatua “Informacion mbi kërkesën e shoqërisë Sunny Side Energy” sh.p.k., të protokolluar me nr. 620/3 prot., datë 25.02.2026, në lidhje me këtë aplikim/procedurë, me anë të së cilës u sqarua se me depozitimin/saktësimin e dokumentacionit të kërkuar, lind nevoja e shqyrtimit përkatës, ndaj afati procedural i këtij aplikimi do të konsiderohet data 24.02.2026, kjo në mënyrë që ERE të vijojë me analizimin e dokumentacionit të depozituar në lidhje me këtë aplikim.

## 2. Shqyrtimi i Kërkesës dhe Dokumentacionit të Paraqitur

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe të neneve 2, gërma “a”, 3, 4 dhe 6 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.07.2016, rezulton se ERE miraton kërkesat e të licencuarave për transferimin e aseteve fikse (të paluajtshme) që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në mbështetje të përcaktimeve të nenit 7 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, rezulton se nevojitet të saktësohet/plotësohet dhe dokumentacioni në vijim:

### Neni 7, Pika 1

- **gërma “h”** Shoqëria “Sunny Side Energy” sh.p.k. duhet të sqarojë/bëjë me dije lidhur me rolin që bashkëkredimarrësit (shoqëria “KASTRATI” sh.p.k.) ka në këtë kredi. Kjo referuar faktit që qëllimi i kësaj kredie është për rikthimin e pjesshëm të fondeve të dhëna nga ortaku dhe/ose borxhit brenda grupit të shoqërive dhe/ose financimi i detyrimeve ndaj furnitorit deri në masën 60% të kostos totale të projektit (pa përfshirë TVSH-në), e nga ana tjetër konstatojmë se si garanci për shlyerjen e detyrimeve kundrejt bankës financuese janë lënë asetet fikse dhe kuotat e shoqërisë “Sunny Side Energy” sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

### Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Sunny Side Energy” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet marrëveshjes siguruese) të aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Intesa SanPaolo Bank Albania” sh.a. (*për*

*kontratën e kredisë nr. 7775 rep, nr. 2810 kol, datë 26.12.2025 dhe marrëveshjen siguruese nr. 1083 rep., nr. 458 kol., datë 24.02.2026).*

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë stë Origjinës, të njoftojë shoqërinë “Sunny Side Energy” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**